



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Vendim

Nr. 46 Date 22/09/ 2017

Për

Dhënien e mendimit për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike për HEC “Gunjes” nga subjekti “Zall Herr Energji” dhe “Superbeton Mati” shpk, Përroi i Gunjës & i Shehut degë e Lumit Mat në Bashkinë Mat, Qarku Dibër.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”(i ndryshuar), me propozim të A.B.U. Mat, **Këshilli i Basenit Ujor Mat**,

Vendosi:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “Zall Herr Energji” dhe “Superbeton Mati” shpk me Administrator Z.Petrit Gaci, për “Përdorim Rezerva Ujore për Energji Elektrike” sipas studimit të paraqitur nga subjekti “Zall Herr Energji” dhe “Superbeton Mati” shpk, me këto të dhëna:

HEC- ”GUNJA”

-Subjektit juridik/fizik : “ **Zall Herr Energji**” dhe “**Superbeton Mati**” shpk:

Veprat e marrjes Dega 1

-Prurja mesatare : $Q= 0.101m^3/sek$,

-Prurja llogarites: $Q= 0.114m^3/sek$,

-Prurja ekologjike: $Q= 0.007 m^3/sek$,

-Prurje per perdorime te tjera: $0.005m^3$

-Kuota e vepres se marrjes 1a $Z=1220 m$, X-44 22 814.9

Y- 45 87 174.3

-Kuota e vepres se marrjes 1b $Z=1220 m$ X-44 22 674.6

Y-45 87 494.6

Veprat e marrjes Dega 2

-Prurja mesatare : $Q= 0.276 m^3/sek$,

-Prurja llogarites: $Q= 0.312m^3/sek$,

-Prurja ekologjike: $Q= 0.016 m^3/sek$,

-Prurje per perdorime te tjera: $0.010 m^3$

-Kuota e vepres se marrjes 2a $Z=1258 m$, X-44 23 589.3

Y- 45 85 333.9

-Kuota e vepres se marrjes 2b $Z=1260 m$ X-44 23 187.06

Y-45 85 704.6

-Kuota e godines se centralit: $Z=1057m$. X- 44 24 168.6

Y-45 87 750.1

-Energjia e planifikuar vjetore: $2 050 339 kwh/vit$,

- Fuqia $500 kw$,ore pune/vit 277

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes, i furnizimit me ujë të popullatës etjere nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT

Ast NIKOLLA

KRYETARI I K.B.U. MAT

Eduard NDRECA

